



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:066204

Datë: 23.10.2023

Numri i dokumentit: 04817945

**SCC-11 - 0087**

**Paditës:** A H T Komuna Malishevë, të cilin e përfaqëson avokati I E, avokat nga Malisheva .

**Kundër**

**Të paditurës :** NSH M e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, Rr. „ Driton Hoxha ’’, nr. 55.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me kolegjin e specializuar gjyqtarin Hasim Sogojeva, Kryesues dhe gjyqtaret Bajram Miftari dhe Diellza Hoxha , në seancë vendimmarrëse, më dt. 23 tetor 2023, mori këtë :

**A K T V E N D I M**

**HEDHET si e pa pranueshme padia e paditësit A H T, kundër të paditurit NSH M.**

**Rrethanat Faktike dhe Procedurale**

Me 06.06.2006, pranë Gjykatës Komunale në Malishevë, është dorëzuar padia e paditësit C. nr. 174/2006 kundër të paditurit për vërtetim pronësie.

Në parashtrësë të paditës është deklaruar se i ndjeri L R T ka qenë pronarë i ngastrave kadastrale nr. ..., në vendin e quajtur „ D ’’ f p nr. 45, me sipërfaqe 1,37.00ha, ZK Banjë.

Në vitet 1950, kjo pronë ju është marrë pa bazë ligjore dhe pa kompensim paditësit, dhe ka pësuar ndryshime sa i përket numrit që është në kuadër të ngastrës nr. 23, vendi i quajtur „R ’’ me sipërfaqe 83,32.26 ha f p nr. 187, ZK B. Ka kërkuar që paditësi të vërtetohet se është pronar i ngastrës nr. 23, vendi i quajtur „R ’’ me sipërfaqe 1,37.00ha, fp. nr. 187, ZK B.

Ka bashkangjitur :

- Aktvendimin nr. 2670, të Komunës së Malishevës

- Fleta e posedimit nr. 187, ZK Banjë,
- Kopja e dokumentit identifikues.

Më dt. 04.11.2008, Gjykata Komunale në Malishevë, ka marrë aktvendim C nr. 174/2006, me të cilën ka pezulluar procedurën.

Më dt. 25.01.2011, Gjykata Komunale në Malishevë, ka marrë aktvendim C nr. 174/2006, me të cilin është shpallur jo kompetente .

Më dt. 07.03.2011, lënda C. nr. 174/2006, është bartur në DHPGJS dhe ka mare shenjën SCC - 11- 0087.

Më dt. 05.05.2023, DHPGJS ka lëshuar Urdhër SCC -11- 0087, për paditësin dhe të njëjtit ju është kërkuar të plotëson padinë në afatin prej 15 ditëve , ashtu që në pikëpamje subjektivë të provon legjitimitetin aktiv , pasi nuk keni dorëzuar dëshminë e vdekjes për paraardhësin L R T, pastaj nuk keni treguar bazën ligjore të kërkesëpadiisë , nuk keni dorëzuar provat në lidhje me historianit e pronës, ekspertizën gjeodezike për identifikim të ngastrës, nuk keni hartuar një listë të provave, dhe nuk keni bërë precizimin e kërkesëpadiisë. Paditësi është njoftuar për pasojën juridike të mos veprimit .

Më dt. 15.05.2023, Urdhrin e kanë pranuar si paditësi ashtu edhe avokati i tij.

Kësaj parashtrese nuk ja ka bashkangjitur asnjë provë .

### **Arsyetimi Ligjor**

#### **Padia e paditësit , hedhet si e pa pranueshme .**

Me dispozitën e nenit 36 të Ligjit nr. 06/L-086, rregullohet ,, Pas pranimit dhe regjistrimit të një kërkesë apo ankese dhe pas dërgimit të saj tek Gjyqtari i vetëm apo Kolegji përkatës, Gjyqtari i vetëm apo respektivisht Kolegji, vendos nëse ajo është e pranueshme në mbështetje të nenit 21 të këtij ligji. 2. Një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse: 2.1. Dhoma e Posaçme ka juridiksion në bazë të nenit 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; 2.2. paditësi ka të drejtë të nisë procedurat në mbështetje të paragrafit 1 të nenit 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; 2.3. kërkesa/ankesa paraqitet kundër një pale që mund të jetë palë kundërshtare në procedurat para Dhomës së Posaçme, në mbështetje të paragrafit 2 të nenit 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; 2.4. kërkesa/ankesa është parashtruar brenda afatit të përcaktuara në këtë ligj apo ligje të tjera në fuqi kur janë të aplikueshme; 2.5. kërkesa/ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 dhe 35 të këtij ligji. 2.6. është bashkëlidhur edhe një kopje e aktit juridik kundër apo ndaj të cilit është paraqitur kërkesa/ankesa”.

Nisur nga fakti se Gjykata, ka lëshuar Urdhrin SCC- 11- 0085, më dt. 05.05.2023 , ndërsa paditësit dhe të autorizuarit të tij Urdhri ju është dorëzuar më dt. 15.05.2023, të njëjtit nuk kanë vepruar përkundër faktit se janë njoftuar me pasojën juridike, sikundër nuk kanë kërkuar ndonjë afat shtesë për plotësimin e padisë.

Gjykata vlerëson se parashtresa e kërkesës pronësore ashtu si është hartuar nga paditësi më dt.22.06.2015, nuk është e hartuar ashtu siç kërkohet me dispozitën e nenin 35 të Ligjit nr. 06/L-086 e në lidhmeri me nenin 99 dhe 253 të LPK-së, pasi të njëjtit i mungojnë provat që vërtetojnë

legjitimitetin aktiv të palës paditëse, baza juridike e kërkesëpadisë, provat në lidhje me vërtetimin e fakteve, sikundër edhe kërkesa për çështje kryesore është e pa kuptueshme për shkak se nuk janë përfshirë të gjitha të dhënat gjeodezike të ngastrës lëndore . Për këtë arsye edhe parashtrësja e padisë është hedhur si e pa pranueshme.

Gjykata, duke zbatuar dispozitën e nenit 36. 2.5 të Ligjit nr. 06/L-086, ankesën/ kërkesën për rishikim pronësore, të paditësit e hedhi si të pa pranueshme.

### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi . Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar Kryesues

Bajram Miftari, Gjyqtar

Diellza Hoxha, Gjyqtare,